



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 695 Prot.

Tiranë, më datë 01.07.2020

VENDIM
Nr. 180, datë 09.06.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 09.06.2020,

VENDOSI:

1. Shtyrjen e vendimmarrjes për projektin kërkimor-shkencor në vazhdim «**Foinike-Butrint, 2020**» drejtuar nga Prof.Dr Shpresa Gjongecaj dhe Prof.Asoc. Belisa Muka (IA) në bashkëpunim me Prof.Asoc. Guiseppe Lepore dhe Prof.Asoc. Enrico Giorgi (Universiteti i Bolonias-Itali), miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga IA në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
Në Foinike, Vijimi i kërkimeve arkeologjike në dy sektorët që u punua edhe gjatë vitit 2019: a) Në terracën në jug të agorasë helenistike; b) Sektori lindor;
Në Butrint : a) Vijimi i rilevimit të mureve rrethuese. Puna do të për qendrohet veçanërisht në traktin e murit që kalon mbi Sanktuarin e Asklepit; b) Vijimi i sondazhit të nisur në vitin 2019, në zonën e akropolit.
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

KRYETAR
Elva MARGARITI

